



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/35/23;
Datë: 31.08.2023 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.08.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa, në tekstin e më poshtëm / (projekt) Rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) rregullorje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa .
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut dhe Drejtorija për Buxhet dhe Financa .
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 2 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Obligohet Kuvendi i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. (Projekt) rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komentëve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Financa e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/36/23;
Datë: 31.08.2023.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.08.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024, në tekstin e më poshtëm / (projekt) Rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) rregullorje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut dhe Drejtorija për Buxhet dhe Financa.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 2 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Obligohet Kuvendi i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. (Projekt) rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Financa e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Më këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Z. Shpejtim Gacaferi



Adresa:

Tel.: +383 (0) 44 270 947
<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/37/23

Datë: 27.09.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe nenit 3 paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.09.2023 nxjerrë:


V E N D I M

për formimin e Grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024

- I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e (projekt) Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024 /në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.
- II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë (projekt) Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024 në përputhje me nenin 22 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.
- III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, , një përfaqësues nga ekzekutivi.
- IV. Grupi punues përbëhet nga:
1. Shpejtim Gacaferi -Kryetar (LDK), Kryesues i Kuvendit,
 2. Mursel Salihaj -anëtar (LDK), Kuvendi Komunal
 3. Zenel Maloku - anëtarë (AAK), Kuvendi Komunal
 4. Eliza Pepsbi -anëtare (LVV), Kuvendi Komunal dhe
 5. Leonora Shehu -anëtare nga ekzekutivi
- IV. Afati i hartimit të (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut është më së largu deri në fund të muajit dhjetor të këtij viti.
- V. Pas hartimit të (projekt) Planit të punës nga ana e Grupit të punës, (projekt) Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministritë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/38/23

Datë: 27.09.2023

Në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048); nenit 40 paragrafi 2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika e) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 19 paragrafi 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur me 27.09.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024

I. Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2024 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Junikut, dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

II. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2024 është: **2,199,837.00 €** dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Stafi për vitin 2024, është **167 punëtorë**.
2. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2024, është : **1,445,893.00 €**
3. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2024, është **246,660.00€**
4. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2024, është **38,500.00 €**
5. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2024, është **62,000.00 €**
6. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2024, është **406,784.00€**

Totali i Buxhetit të aprovuar për vitin 2024, është 2,199,837.00 €

III. Komuna e ka bërë planifikimin duke respektuar kufijtë e Qarkores buxhetore 2024/02 për Komuna.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi respektivisht ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024 sipas linjave buxhetore nga pika II e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës së Junikut.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/39/23
Datë: 27.09.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 27.09.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për

ri-alokim te mjeteve të mbetura buxhetore për vitin 2023

- I. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Junikut për bartjen e mjeteve të mbetura nga projekti nr. 53877 nga të hyrat vetanake në vlerë prej **3,439.25 € Planifikimi Urban dhe Mjedis (660) Nën programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66405) kodi funksional (0620).** 53877 Ndërtimi i kanalizimit sekondar për ujra të zeza lokacioni “Bajraktar - 7 shtatori dhe Qendër “ (3,439.25 €).
- II. Mjetet e Mbetura propozohen që të rialokohen në programin: Planifikimi Urban dhe Mjedis (660), Nën programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66405) kodi funksional (0620). 53439 Rekonstruimi i Rrugës Gaxherr Bajraktar 3,439,25€
- III. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në çeb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gaçafëri

Kryesues

